

VENDIM
Nr.1241, datë 16.12.2009

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT TË
“BIBLIOTEKËS SË KADAREVE” GJIROKASTËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit të “Bibliotekës së Kadareve”, Gjirokastrë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Gjirokastrë.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 144 (njëqind e dyzet e katër) m² truall dhe 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim 3-katësh, me çmim 11 938 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tetë) lekë/ m², vlerësuar në shumën e përgjithshme 5 367 480 (pesë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

5. Shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

7. Punimet për realizimin e projektit të përfundojnë brenda datës 31.3.2010.

8. Regjistrimi i pasurisë së paluajtshme, në emër të drejtorisë rajonale të kulturës kombëtare, Gjirokastrë, i përbërë nga 144 (njëqind e dyzet e katër) m² truall dhe 96 (nëntëdhjetë e gjashtë) m² ndërtim 3-katësh, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe drejtoria rajonale e kulturës kombëtare, Gjirokastrë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR RESTAURIMIN E “SHTËPISË SË
KADARESË” DHE KTHIMIN E SAJ NË INTERES PUBLIK**

Rrethi Gjirokastrë

Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: truall dhe banesë 3-katëshe

Shpronësim definitiv

<i>N R.</i>	<i>EMRI</i>	<i>ATËS IA</i>	<i>MBIE MRI</i>	<i>LLOJ I PASUR ISË</i>	<i>NR. KADAST RAL</i>	<i>NR. PASUR ISË</i>	<i>SIP. E SHPRONËS UAR</i>	<i>ÇMIM I NË</i>	<i>ADRESA</i>
-----------------	-------------	--------------------	---------------------	---------------------------------	-------------------------------	------------------------------	------------------------------------	--------------------------	---------------

							<i>NË M²</i>	<i>LEKË/ M²</i>	
<i>1</i>	<i>GRIGOR(G OLE)</i>	<i>PAVL I</i>	<i>VASHO</i>	<i>TRUAL L DHE BANES Ë 3- KATËS HE</i>	<i>8542</i>	<i>3/5</i>	<i>144 DHE 96</i>	<i>11.938</i>	<i>GJIROKAS TËR</i>